

**VENDIM**  
**Nr. 862, datë 20.12.2006**

**PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES”  
SHA**

*(Ndryshuar me VKM nr. 436, datë 8.4.2008)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të nenit 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a. të ndajë divizionin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të krijojë shoqërinë “Operatori i sistemit të shpërndarjes” (OSSH) sh.a.

2. Operatori i sistemit të shpërndarjes (OSSH) sh.a. ka kapital 100 për qind shtetëror, me aksionar të vetëm KESH sh.a.

3. Objekti kryesor i veprimtarisë së OSSH sh.a. është të sigurojë, nga rrjeti i saj i shpërndarjes së energjisë elektrike, për zonat që mbulohen:

a) furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike të klientët tariforë, të lidhur me rrjetin e shpërndarjes, me përjashtim të klientëve të kualifikuar;

b) operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të mjediseve dhe pajisjeve, në administrim të saj, në përputhje me kërkesat teknike;

c) menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike;

ç) zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe të ndryshimit të kërkesës në rajon ose në territor;

d) shërbime të tjera për klientët, të nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

4. KESH sh.a., me cilësinë e aksionarit të vetëm të OSSH sh.a., autorizohet të bëjë ndarjen e aseteve fikse dhe të llogarive financiare, që rrjedhin, për shoqërinë e krijuar, sipas këtij vendimi, në përputhje me bilancin e datës 31.12.2006.

5. KESH sh.a. gëzon të drejtën si pjesëmarrës në asetet e OSSH sh.a. deri në çastin e kalimit të tyre në kapitalin e shoqërisë së krijuar, me këtë vendim. Të drejtat dhe detyrimet më 31.12.2006 mbeten për llogari të KESH sh.a., *me përjashtim të pjesës së detyrimeve, që lidhen me huatë/ kreditë afatgjata nga donatorët e huaj, që janë, disbursuar dhe materializuar, dhe që do të materializohen në të ardhmen si pjesë e aseteve të OSSH sh.a.-së, në kuadër dhe në zbatim të projekteve e të marrëveshjeve përkatëse me kreditorët e huaj, sipas të cilave KESH sh.a.-ja do të mbetet në rolin e kredimarrësit ose të nënkredimarrësit, kur kredimarrëse është qeveria.*

*5/1 Asetet në administrim të KESH sh.a.-së, që i kalojnë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), sha, të regjistrohen në pronësi të këtij operatori.*

*5/2. Pronësia e aksioneve të OSSH sh.a.-së, transferohet nga KESH sh.a.-ja, te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.*

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**